Albanian

## Ndihmë për azilkërkuesit në zonën e Bristolit

## Përditësuar: nëntor 2021

Këto informacione janë në dispozicion në arabisht, somalisht, kurdisht sorani, pashtoisht, farsisht, urduisht, shqip, bengalisht, frëngjisht, mandarin dhe vietnamisht. Përkthimet janë këtu https://www.bristolrefugeerights.org/how-we-help/i-need-help-i-start/

---

**Bristol Refugee Rights (Të Drejtat e Refugjatëve të Bristolit).** www.bristolrefugeerights.org

**Linja e ndihmës** Telefonata/ mesazhe me tekst/ WhatsApp: 07526 352353.

Hapur të martën dhe të mërkurën, ora 10:00-13:00

Na tregoni emrin dhe numrin tuaj të telefonit. Do t'ju telefonojmë ne kur të kemi mundësi. Nëse keni nevojë për një përkthyes, na tregoni se cilën gjuhë flisni.

**E RE Seancë këshillimi dhe informimi të mërkurave, 10:00-12:00**

në The Wellspring Settlement Main Hall, 43 Ducie Road, Bristol, BS5 0AX

*Ndihmë me strehimin për azilin, mbështetje për azilin ose kërkesën për azil · Përfitimi i kujdesit shëndetësor · Plotësimi i formularit dhe udhëzime. Nuk ka nevojë për takim. Do t'i takojmë njerëzit sipas radhës që mbërrijnë dhe mund t'ju kërkohet që të ktheheni sërish për një takim më të gjatë një ditë tjetër.*

**Hapësira sociale të enjteve, 10:00-13:00**

në The Wellspring Settlement Main Hall, 43 Ducie Road, Bristol, BS5 0AX

*Çaj, kafe dhe ushqime të lehta · Lojëra · Një mundësi për të takuar njerëz të rinj dhe për të zënë shokë. Nuk ka nevojë për takim*

Ofrojmë gjithashtu kurse të gjuhës angleze, çerdhe, mbështetje për familjen, grupin Pride Without Borders (Krenaria pa Kufij), Projektin Young People's Immigration (Imigrimi i të Rinjve). Pyesni nëse keni nevojë për ndihmë me kredit telefonik ose bileta udhëtimi.

---

**Red Cross Refugee Support and International Family Tracing (Mbështetja e Kryqit të Kuq për Refugjatët dhe Zbulimi i Familjes Ndërkombëtare)**

https://www.redcross.org.uk/get-help/get-help-as-a-refugee

**telefon 0117 941 5040, mesazhe me tekst ose WhatsApp 07739 863 036 / email** refugeeservicebristol@redcross.org.uk

Ne ofrojmë mbrojtje dhe këshilla për personat që u është dhënë rishtazi leja për të qëndruar, të cilët kanë nevojë për ndihmë me përfitimet dhe aplikimet e të pastrehëve për strehim, këshilla për bashkim familjar, aplikime për dokumente udhëtimi, mbështetje për varfërinë dhe gjetjen e anëtarëve të familjes. Do të përpiqemi të jemi në dispozicion **të hënën, të mërkurën dhe të premten, 11:00-15:00** Nëse nuk merrni përgjigje, lini një mesazh ose na shkruani dhe një punonjës i çështjes do t'ju kontaktojë sërish.

Albanian
Na tregoni emrin tuaj ose të personit në emër të të cilit po telefononi, numrin e telefonit dhe arsyen e telefonatës.

---

**Refugee Women of Bristol (Gratë Refugjate të Bristolit) Telefon 0117 9415867 /info@refugeewomenofbristol.org.uk**

**Qendra pa rezervim e Refugee Women of Bristol** **është e hapur vetëm gjatë periudhës së shkollës, nga ora 10:00-14:30** në **Easton Family Centre (Qendra e Familjes Easton) (Bristol BS5 0SQ).**

Ne ofrojmë mbështetje emocionale dhe praktike për gratë, duke përfshirë ato që përjetojnë dhunë në familje; interpretimin e informacioneve të përditësuara nga qeveria dhe NHS-ja; mbështetim anëtarët tanë për të shfrytëzuar kujdesin mjekësor. Zhvillimi i kurseve javore të ESOL-it, artit dhe zejtarisë, seanca në linjë/ballë për ballë zumba, kafeja e mëngjesit dhe programi i miqësimit e mbështetjes së komunitetit. Punojmë gjithashtu me rrjetin tonë të grave më të stabilizuara për të mbështetur ato që janë më të izoluara. Do të përpiqemi të jemi në dispozicion çdo ditë të javës. Nëse nuk merrni përgjigje, lini një mesazh ose na shkruani dhe një punonjës i komunitetit do t'ju telefonojë sërish.

---

**Borderlands** https://borderlands.uk.com

**Telefon: 01179040479**
**hello@borderlands.org.uk**

Mund të sigurohen çanta me **ushqime** dhe **ushqime që mund të merren me vete (ushqim hallall) të martave** nga ora 12:30-13:30 nga The Assisi Centre (Qendra Assisi), Lawfords Gate, BS5 0RE.

**Kurse të gjuhës angleze** për fillestarët në gjuhën angleze dhe të shkrimit e leximit (Pre-Entry dhe Entry 1). Për më shumë informacion ose për të referuar dikë në kurset e gjuhës angleze, kontaktoni Sara-n, sara@borderlands.org.uk 07563 029 027.

**The Mentoring Project (Projekti i Mentorimit)** ofron mbështetje emocionale dhe praktike kokë më kokë për azilkërkuesit dhe refugjatët për një periudhë 6-9 mujore. Për më shumë informacion ose për të referuar dikë, dërgojini email Jess-it në jess@borderlands.org.uk 07732 901175 dhe/ose Olivia-s olivia@borderlands.org.uk 07732 901174.

**Seancë gjumi dhe qetësimi**: kjo hapësirë mundësohet nga Recovery Navigators (Navigatorët e Rimëkëmbjes) i ekipit HOPE, dhe synon të mbështetë azilkërkuesit dhe refugjatët për t'u qetësuar dhe për të mësuar se si të përmirësojnë gjumin e tyre. Ne zhvillojmë seanca të veçanta për burra dhe gra, çdo dy javë, në sallën kryesore në Borderlands-it. Për më shumë informacion ose për të rezervuar një hapësirë, dërgoni email: marta@borderlands.org.uk 07925 133225.

---

**Bristol Hospitality Network (Rrjeti i Mikpritjes i Bristolit)** https://www.bhn.org.uk/

hello@bhn.org.uk

Albanian
Strehim për azilkërkuesit e varfër që u është refuzuar azili në rrjetin tonë të familjeve vullnetare pritëse dhe shtëpitë e burrave.

Referimet pranohen VETËM përmes Bristol Refugee Rights (Të Drejtat e Refugjatëve të Bristolit).

Shërbimet e BHN-së janë të gjitha VETËM për anëtarët e pritur nga BHN-ja.

- Qendra e mirëseardhjes të hënave për anëtarët e BHN-së duke përfshirë mundësitë në dispozicion për azilkërkuesit dhe refugjatët për të bërë punë vullnetare, na kontaktoni.

- Fondi i Solidaritetit për anëtarët e BHN-së

- ESOL, qepje, berber etj. për anëtarët e BHN-së

---

**Aid Box Community (Komuniteti i Arkës së Ndihmave)**
https://www.aidboxcommunity.co.uk/

**174b Cheltenham Road, Bristol BS6 5RE  Telefon 017 336 8441**

**Aid Box Connections (Lidhjet e Arkës së Ndihmave)** mund t'ju lidhë me një vullnetar të ABC-së, i cili do të mbajë kontakte të rregullta dhe do të bëhet një mik me të cilin mund të flisni.
**Aid Box Free Shop (Dyqani pa Pagesë i Arkës së Ndihmave)** - Mund të porositni sende të domosdoshme të jetesës si veshje, produkte për tualetin, çanta dhe këpucë në dyqanin tonë pa pagesë, mund t'i dorëzojmë ne ose mund t'i merrni vetë. https://tinyurl.com/yy3vtvh8
Ose dërgoni email në clare@aidboxcommunity.co.uk për të rezervuar një takim për të vizituar dyqanin.

**Aid Box Womans Group (Grupi i Grave të Arkës së Ndihmave)** - Takohemi të hënën për shoqëri, argëtim, vallëzim, joga dhe ushqim kur të mundemi. Kontakt heather@aidboxcommunity.co.uk

**Aid Box Mens Group (Grupi i Burrave të Arkës së Ndihmave)** Të hënën, klubi i futbollit. Kontakt heather@aidboxcommunity.co.uk

---

**Project MAMA (Projekti MAMA)** https://projectmama.org/

Projekti Mother Companions (Shokët e Nënës): Project MAMA pranon referime për gratë shtatzëna për mbështetje kokë më kokë gjatë gjithë shtatzënisë, paralindjes e lindjes dhe fillimeve

të të qenit prind. Ne ofrojmë mbështetje të specializuar kokë më kokë, veçanërisht për ato që nuk kanë partnerë të lindjes. Referimet mund të bëhen nëpërmjet uebsajtit tonë ose duke i telefonuar zyrës në 0117 941 5320.

MAMAhub: një hapësirë për nënat refugjate, azilkërkuese dhe të shpërngulura që janë shtatzëna dhe me foshnja nën 2 vjeç. Është një hapësirë për mbështetjen dhe solidaritetin midis të barabartësh, ku ato mund të shijojnë një vakt të ngrohtë e të shëndetshëm, krijimin e lidhjeve me foshnjat, seanca joga dhe qetësimi.

MAMAhub funksionon çdo të premte gjatë periudhës së shkollës, nga ora 11:00 - 14:00 nga Felix Road Adventure Playground, Felix Rd, Easton, Bristol BS5 0JW.
Rimbursojmë tarifat e autobusit.